

NEWSLETTER

Universiteti Bujqësor i Tiranës

Ceremonia e Diplomimit në Universitetin Bujqësor të Tiranës për të gjithë studentët e vitit akademik 2023-2024

Universiteti Bujqësor i Tiranës diplomoi rreth 1500 studentë në Ceremoninë e Diplomimit të vitit akademik 2023-2024. Kjo është një ngjarje e paharrueshme, një moment kulmor ku festohen arritjet e studentëve që mbyllën me sukses studimet e tyre dhe që janë gati të hyjnë në botën e profesionit. Urime të përzemërta të gjithë studentëve të diplomuar dhe shumë suksese në rrugëtimin e tyre profesional drejt së ardhmes. Faleminderit që keni zgjedhur Universitetin Bujqësor të Tiranës!

**MË TË LEXUAR:**

WEB

[HTTPS://WWW.UBT.EDU.AL/SQ/BLOG/UNIVERSITETI-13/CEREMONIA-E-FILLIMIT-TE-VITIT-AKADEMIK-2024-2025-NE-UNIVERSITETIN-BUJQESOR-TE-TIRANES-594](https://www.ubt.edu.al/sq/blog/universiteti-13/ceremonia-e-fillimit-te-vitit-akademik-2024-2025-ne-universitetin-bujqesor-te-tiranes-594)

UBREEN

Follow us:

UNIVERSITETIN
BUJQËSOR TË TIRANËS



UNIVERSITETI_BUJQESOR
_TIRANES



Ceremonia e shpërndarjes së diplomave për titujt akademikë “Profesor” dhe “Profesor i Asociuar.”

Ceremonia e hapjes së Programit të Specializimit Afatgjatë në Siguri Ushqimore dhe Shëndet Publik Veterinar

Në Universitetin Bujqësor të Tiranës u inagurua hapja e një programi inovativ specializimi pasuniversitar në fushën e sigurisë ushqimore dhe shëndetit publik veterinar në Ballkanin Perëndimor, i cili për herë të parë do të realizohet në gjuhën angleze me qëllim përafrimin me standardet europiane. Objektivat projektit kanë qëllim të përmirësojnë: cilësinë e arsimit të lartë nëpërmjet teknikave innovative të të mësuarit; njohuritë dhe aftësitë e specialistëve në disiplinat e lidhura me shëndetin publik, mjekësinë veterinare, prodhimin shtazor etj.



Konferencë Kombëtare me temë: “Zhvillimi i Teknologjisë dhe Transferimi i Njohurive në Sektorin e Bimëve Mjekësore dhe Aromatike në Shqipëri”

Universiteti Bujqësor i Tiranës, në bashkëpunim me shoqatat e sektorit të bimëve aromatike dhe mjekësore, dhe me mbështetjen e RisiAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), zbatuar nga Helvetas, realizuan Konferencë Kombëtare me temë: “Zhvillimi i Teknologjisë dhe Transferimi i Njohurive në Sektorin e Bimëve Mjekësore dhe Aromatike në Shqipëri”. Kjo konferencë shënon një hap të rëndësishëm drejt inovacionit, transferimit të teknologjisë dhe shkëmbimit të njohurive brenda sektorit të BAM në Shqipëri.



Ambasadorja e re e Republikës së Austrisë në Shqipëri, Sh.S. znj. Monica Zach, zhvilloi një vizitë në Universitetin Bujqësor të Tiranës, ku u prit nga stafi drejtues i UBT.

Sh.S. Ambasadorja Zach shprehu gatishmërinë e vazhdueshme të ndihmës dhe mbështetjes së qeverisë austriake ndaj Projektit UBT-BOKU 2030, e cila konsiderohet si një ndër projektet më të rëndësishme që qeveria austriake po mbështet në Shqipëri.



NEWSLETTER

Universiteti Bujqësor i Tiranës

Ceremonia e fillimit të vitit akademik 2024-2025 në Universitetin Bujqësor të Tiranës

Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, uroi nisjen e vitit të ri akademik 2024-2025 në Shqipëri nga Universiteti Bujqësor i Tiranës.

Studentë të dashur, UBT ju shpreh angazhimin e plotë për t'ju ofruar dije dhe eksperiencë akademike e profesionale në nivelet e standardeve ndërkombëtare. Ne do jemi gjithnjë krahëhapur për ju dhe mbështetës në rrugëtimin e karrierës suaj pranë këtij Universiteti. Ky fillim vit akademik, i mbushur me energji optimiste dhe pritshmëri, premtan të jetë një periudhë e suksesshme për të gjithë ata që janë pjesë e këtij institucioni të rëndësishëm.



MË TË LEXUAR:

WEB

[HTTPS://WWW.UBT.EDU.AL/BLOG/UNIVERSITETI-1-13/CEREMONIA-E-FILLIMIT-TE-VITIT-AKADEMIK-2024-2025-NE-UNIVERSITETIN-BUJQESOR-TE-TIRANES-594](https://www.ubt.edu.al/blog/universiteti-1-13/ceremonia-e-fillimit-te-vitit-akademik-2024-2025-ne-universitetin-bujqesor-te-tiranes-594)

UBREEN

Follow us:



UNIVERSITETIN
BUJQËSOR TË TIRANËS



UNIVERSITETI_BUJQESOR
_TIRANES



Vizitë e delegacionit të Akademisë së Shkencave të Lituanisë në UBT

Takimi i radhës i ekipit të UBT dhe BOKU

Misioni i BOKU vazhdon në takimin e radhës në Universitetin Bujqësor të Tiranës duke diskutuar me stafin akademik dhe drejtues mbi implementimin e projektit UBT-BOKU 2030.

Ekipi i BOKU dhe grupet e punës së UBT për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor shkëmbyen ide dhe dakordësuan mendime lidhur me programet që duhen për të mbuluar kompetencat bazë të UBT, mbi bazën e të cilëve më pas do të riorganizohen programet mësimore Bachelor dhe Master.



Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin Ndërkombëtar Helenik të Selanikut, Greqi

Në kuadër të intensifikimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, Universiteti Bujqësor i Tiranës vazhdon zgjerimin e kontakteve me Institucione partnere me interes në fushën e edukimit, kërkimit shkencor dhe transferimit të teknologjisë në fushën e bujqësisë. Më datë 18 Tetor 2024, u firmos marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe Universitetit Ndërkombëtar Helenik të Selanikut, Greqi (International Hellenic University, Greece), nga Prof. Stamatis Angelopoulos, Rektor i Universitetit Ndërkombëtar Helenik të Selanikut, Greqi dhe Rektorin e Universitetit Bujqësor të Tiranës, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku.



Në ambientet e Universitetit Bujqësor të Tiranës u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit mes UBT dhe Universitetit të Pyjeve në Sofie, Bullgari, me praninë e Ambasadorit të Bullgarisë në Shqipëri, Sh. T. Z. Momchil Raytchevski .

Dy institucionet, përfaqësuar nga Rektorin e UBT, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku dhe Prof. Asoc. Dr. Hristo Mihaylov, me anë të kësaj marrëveshjeje hapën rrugë për forcimin e marrëdhënieve dypalëshe, kryesisht në fushën e kërkimit shkencor dhe shkëmbimit të studentëve, stafit akademik apo ndihmës akademik përmes programit Erasmus .



Universiteti Bujqësor i Tiranës

UBT-BOKU 2030, takim mbi strukturimin dhe përmirësimin e kurrikulës së universitetit

Kemi mbërritur në takimin e tretë me ekipin e BOKU në kuadër të zbatimit të projektit të riorganizimit të UBT sipas modelit të Universitetit BOKU të Vjenës për të folur këtë herë mbi strukturimin dhe përmirësimin e kurrikulës së UBT. U bë një vlerësim i shumëanshëm i kurrikulës aktuale për të siguruar që programet akademike të jenë rigorozë, duke i përgatitur studentët për karrierën dhe rritjen e tyre profesionale. Përgjatë dy ditëve u zhvilluan takime me të gjithë grupet mësimore të fakulteteve referuar rishikimit të përmbajtjes dhe strukturës së tyre, vlerësimit të programeve aktuale Bachelor, identifikimit të nevojave dhe hapësirave për ndryshim në strukturorë, mundësitë e përmirësimit të kurrikulës në përputhje me kapacitetet e mësimdhënies.

**MË TË LEXUAR:****WEB**

[HTTPS://WWW.UBT.EDU.AL/SQ/BLOG/UNIVERSITETI-13/UNIVERSITETI-BUJQESOR-I-TIRANES-MERR-PJESE-NE-TAKIMIN-E-G7-PER-BUJQESINE-DHE-PESHKIMIN-585](https://www.ubt.edu.al/sq/blog/universiteti-13/universiteti-bujqesor-i-tiranes-merr-pjese-ne-takimin-e-g7-per-bujqesine-dhe-peshkimin-585)

UBREEN**Follow us:**

UNIVERSITETIN
BUJQËSOR TË TIRANËS



UNIVERSITETI_BUJQËSOR
_TIRANES



Aktivitetet në kuadër të projektit “Ngritja e një Qendre Gjeoinformacioni për Ballkanin Perëndimor në UBT”

EVOOlution Masterclass Albania në UBT

Një event për të promovuar zinxhirin e vlerës së vajit të ullirit në Shqipëri, u zhvillua në UBT, në qendrën e vetme në vend që ofron njohuritë dhe ekspertizën për përmirësimin cilësor të këtij sektori. Rektori Sallaku i uroi mirëseardhjen Zv. Ministrit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Z. Dhimitër Kote; Konsullit Diplomatik të Ambasadës Italiane në Shqipëri, Z. Sergio Alias; Përfaqësuesit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nga Kooperacioni Italian në Shqipëri (AICS), Z. Franco Turri; Përfaqësuesit të Tecnopolo Forli-Cesena të Rajonit të Emilia-Romagna, Z. Lorenzo Ciapetti; përfaqësues nga Universiteti i Bolonjës, Sara Barbieri (Drejtuese e Panel Testit të Vajit të Ullirit) dhe Prof. Asoc. Enrico Valli; kompanive shqiptare e italiane në tregun e vajit të ullirit dhe fermerëve e bizneseve të ndryshme.



Ceremonia e Konstituimit të Senatit Akademik dhe Emërimit të Drejtuesve të Njësisë Kryesore UBT

Kjo është një ngjarje tepër e rëndësishme për zhvillimin dhe forcimin e strukturës akademike të UBT-së që do të ndihmojë në jetësimin e vizionit për të ardhmen e Universitetit. Rektori i Universitetit, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, shprehu mirënjohjen dhe falenderimet për kontributin e çmuar e frytdhënës të drejtuesve të njësisë të UBT që përfunduan mandatin dhe uroi drejtuesit e rinj për një mandat të suksesshëm, të përkushtuar në përgjegjësitë e tyre të reja, strategjitë efektive dhe objektivat premtuese të UBT.



Universiteti Bujqësor i Tiranës merr pjesë në takimin e G7 për bujqësinë dhe peshkimin

Me 25-26 Shtator 2024, Rektori i UBT, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku ishte i ftuar në takimin e organizuar në Siracusa, në Sicili të Italisë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve më të lartë të vendeve të G7 për çështjet e zhvillimit të sektorit të bujqësisë dhe peshkimit në Afrikë dhe rajon.

Qëllimi kryesor i këtij takimi kishte të bënte me diskutimet mbi çështjet aktuale që sektori i bujqësisë dhe peshkimit po ndesh, në kushtet e sfidave e konflikteve të ndryshme që po kalon rajoni, si dhe me nevojën për përshtatje me ndryshimet klimaterike.



NEWSLETTER

Universiteti Bujqësor i Tiranës

Vizitë e SH. S. Znj. Tanja Fajon në UBT

Të nderuar të prisnim SH. S. Znj. Tanja Fajon, Zv.Kryeministren dhe Ministren për Punët e Jashtme dhe Çështjet Evropiane të Republikës së Sllovenisë, një figurë që ka luajtur rol të rëndësishëm në rrugën e Shqipërisë drejt BE-së duke kontribuar në procesin e liberalizimit të vizave për shtetasit shqiptarë. E shoqëruar nga Ambasadori i Sllovenisë në Shqipëri, Sh.T. Z. Milan Jazbec dhe stafi i Ambasadës, Znj. Fajon u prit në një takim të veçantë nga Rektori i UBT, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku së bashku me gjithë ekipin drejtues. U diskutuan mundësitë e bashkëpunimit të mëtejshëm ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë mes dy vendeve dhe rëndësia e përkrahjes së integritit evropian të Shqipërisë.



MË TË LEXUAR:

WEB

[HTTPS://WWW.UBT.EDU.AL/BLOG/UNIVERSITETI-13/VIZITA-E-ZNJ-TANJA-FAJON-DHE-AMBASDES-SLLOVENE-550](https://www.ubt.edu.al/blog/universiteti-13/vizita-e-znj-tanja-fajon-dhe-ambades-slovene-550)

UBREEN

Follow us:



UNIVERSITETIN
BUJQËSOR TË TIRANËS



UNIVERSITETI_BUJQËSOR
_TIRANES



Hapen regjistrimet në Universitetin Bujqësor të Tiranës 30 Gusht-13 Shtator

Emërtimi i Rektorit të Universitetit për katër vitet e ardhshme

Në mbështetje të nenit 92, shkronja "g", nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 39, pika 8 e ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe mbi bazën e rezultateve të zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese në universitetet publike, përcjellë nga Ministri i Arsimit dhe Sportit, dekretohet emërimi i Rektorit të Universitetit Bujqësor të Tiranës, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku



Ambasadori i Sllovenisë në Shqipëri, Prof. Dr. Milan Jazbec viziton UBT

Vizita e Ambasadorit të Sllovenisë në Shqipëri në Universitetin Bujqësor të Tiranës, hodhi themelet për bashkëpunimin akademik dhe shkëmbimin e eksperiencave midis dy vendeve.

Ambasadori u prit nga Rektori i UBT, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku dhe stafi i tij, të cilët ndanë arritjet dhe objektivat e institucionit në fushën e bujqësisë, agrobiznesit dhe inovacionit rural.

Gjatë takimit, u diskutuan mundësitë për krijimin e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe programeve të shkëmbimit studentor, të cilat do të forcojnë lidhjet akademike dhe shkencore mes institucioneve akademike të dy vendeve.



Takim me Ministren e Arsimit dhe Sporteve, Znj. Ogerta Manastirliu dhe rektorët e zgjedhur të universiteteve publike për draft-dokumentin e Politikave të Zhvillimit të Arsimit të Lartë 2030 dhe përcaktimin e prioritetëve strategjike afatshkurtra dhe afatmesme.

U bashkërenduan synimet për rritjen e cilësisë, modernizimin e kurrikulave dhe programeve të studimit bazuar në:

- Përmirësimin e ofertës akademike përmes ndërkombëtarizimit,
- Mbështetjen studentore dhe sigurimin e kushteve më të larta të mësimdhënies, kërkimit shkencor, praktikave të punësimit dhe punësimit sipas nevojave të tregut,
- Zhvillimin dhe riorganizimin e kërkimit shkencor,
- Digjitalizimin e shërbimeve arsimore dhe platformën e re të informacionit për kërkimin shkencor.



NEWSLETTER

Universiteti Bujqësor i Tiranës

Merr udhë projekti UBT- BOKU 2030

Nisi puna për implementimin e projektit UBT-BOKU 2030, i celebruar vetëm një muaj më parë. Në këtë fazë po diskutohet mbi kriteret dhe treguesit që lidhen me ofertën akademike, procesin mësimor dhe të gjithë aspektet e tjera në kuadër të kësaj fushe. Pas prezantimit të drejtuesit të projektit Dr. Thomas Koller, përfaqësuesi i BOKU që do të qëndrojë në UBT një pjesë të konsiderueshme kohore gjatë realizimit të projektit, ekipi i BOKU i përbërë nga Prof. Hubert Hasenauer dhe Prof. Hans Peter Kaul prezantuan ofertën akademike dhe eksperiencën e BOKU, si dhe sqaruan treguesit që do të duhen për të filluar procesin e analizës së situatës në UBT. Gjatë kësaj faze parashikohet përgatitja e një analize gjithëpërfshirëse të ofertës aktuale akademike të UBT duke integruar edhe dokumentet ekzistuese përveç çdo “fushe” të pambuluar ende.



MË TË LEXUAR:

WEB

[HTTPS://WWW.UBT.EDU.AL/SQ/BLOG/UNIVERSITETI-13/MERR-UDHE-PROJEKTI-UBT-BOKU-2030-536](https://www.ubt.edu.al/sq/blog/universiteti-13/merr-udhe-projekti-ubt-boku-2030-536)

UBREEN

Follow us:



UNIVERSITETIN
BUJQËSOR TË TIRANËS



UNIVERSITETI_BUJQËSOR
_TIRANES



NDËRKOMBËTARIZIMI DHE MUNDËSI SHKËMBIMI

UBT- BOKU 2030 mundësia e artë për çdo student që zgjedh UBT, diploma duale dhe ofron programe shkëmbimi



Bursa Studimi SA PAGA MINIMALE

PËR PROGRAMET PRIORITARE TË STUDIMIT
PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025

UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit



PROGRAME AKADEMIKE TË SPECIALIZUARA

Pse duhet të regjistroheni në UBT për të studiuar?

Inaugurohet Laboratori Horti Smart Lab, laborator i ri në UBT pranë Departamentit të Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peizazhit

Horti Smart Lab, në funksion të kërkimit dhe këshillimit në prodhimin dhe ruajtjen e frutave e perimeve, është një laborator i bujqësisë smart (të mençur) që do të kryejë kërkim shkencor dhe do të ofrojë shërbime duke përdorur kryesisht metoda jo-shkatërruese për vlerësimin e cilësisë dhe maturimin e frutave, rrushit, perimeve etj; vlerësimin e përbërjes dhe cilësisë së tyre (ngjyra, pesha, fortësia, aciditeti, përmbajtja e lëndëve të ngurta të tretshme, përmbajtja e lëndës së thatë) si dhe përmbajtjen e etilenit, acideve organike dhe sheqernave në fruta.



Kurs Trajnimi “Hyrje në Sistemet e Informacionit Gjeografik”

Kurs organizohet në kuadër të projektit Ngritja e Qendres Gjeoinformative për Ballkanin Perëndimor në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Me pjesëmarrjen e rreth 22 pjesëmarrësve, përfaqësues të komunitetit shkencor dhe akademik të disiplinave të ndryshme, si dhe përfaqësues nga institucione të ndryshme shtetërore të ardhur nga vendet e Ballkanit Perëndimor, si dhe përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, QTTB Fushë-Krujë dhe staf i interesuar i UBT, ky kurs do t'ju sigurojë pjesëmarrësve njohuri thelbësore dhe aftësi praktike në përdorimin e Sistemit të Informacionit Gjeografik (GIS) dhe analizën e të dhënave hapësinore. Në përfundim të trajnimit u shpërndanë certifikatat e para për pjesëmarrësit.



**Universiteti Bujqësor i Tiranës
bëhet pjesë e Konferencës
Ndërkombëtare: “Kontrolli i
cilësisë së ajrit dhe ujit: Faktorë të
rëndësishëm në mbrojtjen e
shëndetit të njeriut dhe ambientit
për zhvillim të qëndrueshëm”.**

Zëvendës Rektorja për Shkencën dhe Projektet, Prof. Dr. Erinda Lika ishte një ndër drejtueset e sesionit “Prespektivat aktuale mbi cilësinë e ajrit dhe të ujit”, ndërsa prezantoi edhe përvojën e saj shkencore mbi rolin e ujërave të zeza si komponent kryesor i qëndrueshmërisë dhe përhapjes në gjenet e rezistencës antimikrobike që ndikojnë në cilësinë e shëndetit mjedisor në Shqipëri.



NEWSLETTER

Universiteti Bujqësor i Tiranës

Në Universitetin Bujqësor të Tiranës u lancua hapja e masterit ndërkombëtar të nivelit të parë “Inovacioni i hapur dhe sipërmarrja rinore në sektorin e gjelbër mesdhetar”

Të lumtur që një tjetër mundësi u vihet në dispozicion studentëve tanë, këtë herë për të qenë ata menaxherët e ardhshëm të inovacionit dhe promovuesit kryesorë të qasjeve dhe metodologjive konceptuale të reja në ndërtimin e ekosistemeve novatore. Realizimi i këtij projekti të rëndësishëm në UBT u bë i mundur falë bashkëpunimit të Universitetit "Giuseppe Degennaro" të Barit, CIHEAM Bari dhe CIHEAM, me mbështetjen e partnerit privat, Intesa Sanpaolo Bank Albania, dhe mbikqyrjen e Rajonit të Pulias, Ministrisë Shqiptare të Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit.



MË TË LEXUAR:

WEB

[HTTPS://WWW.UBT.EDU.AL/SQ/BLOG/UNIVERSITETI-13/UNIVERSITETI-BUJQESOR-I-TIRANES-GJITHNJE-NE-MBESHTETJE-TE-SEKTORIT-TE-BIMEVE-MEDICINALE-DHE-AROMATIKE-PER-TRANSFERIM-TE-TEKNOLOGJISE-DHE-NJOHURIVE-NE-BUJQESI-NE-KETE-SEKTOR-NE-SHQIPERI-509](https://www.ubt.edu.al/sq/blog/universiteti-13/universiteti-bujqesor-i-tiranes-gjithnje-ne-mbeshtetje-te-sektorit-te-bimeve-medicinale-dhe-aromatike-per-transferim-te-teknologjise-dhe-njothurive-ne-bujqesi-ne-kete-sektor-ne-shqiperi-509)

UBREEN

Follow us:



UNIVERSITETIN
BUJQËSOR TË TIRANËS



UNIVERSITETI_BUJQESOR
_TIRANES



Trajnim nga profesorët e UBT në kuadër të Skemës Kombëtare të Trajnimit në Bujqësi

Universiteti Bujqësor i Tiranës nënshkruan Memorandum Mirëkuptimi me Universitetin Kirikkale në Turqi

Rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku dhe Rektori i Universitetit Kirikkale në Turqi, Prof. Dr. Ersan Aslan, firmosën Memorandumin e Mirëkuptimit për zgjerimin e bashkëpunimit në fushën arsimore dhe kërkimore. Të dyja palët do të angazhohen në zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta arsimore e kërkimore për studentët dhe pedagogët, që përfshin shkëmbimin e pedagogëve dhe studentëve, studimin jashtë vendit, programe kërkimore bashkëpunuese, seminare, workshope dhe programe shërbimi.



Congratulation stafit të Universitetit Bujqësor të Tiranës në projektet READ!!!!

Në datë 4 Qershor takimi me fituesit e thirrjes së tretë në projektin (READ) Research Expertise nga Academic Diaspora, mbështetur nga Albanian- American Development Foundation (AADF). Universiteti Bujqësor i Tiranës është fitues i 4 projekteve në programin READ që do të implementohen në bashkëpunim me Diasporën Akademike. Gjatë takimit pjesëmarrësit u prezantuan me procedurat e raportimit mbi ecurinë e projektit. Falenderues për bashkëpunimin me AADF që gjithmonë mbështet kërkuesit në rritjen e cilësisë në kërkimin shkencor dhe fuqizimin e universiteteve.



Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe Megatek

Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku dhe Administratori i Megatek, Z. Dionis Teqja shprehën entuziazmin e tyre për këtë bashkëpunim të ri, i cili do të sjellë mundësi praktike, internshipe, projekte kërkimore dhe inovacione, programe trajnimi dhe zhvillimi profesional për studentët dhe stafin e UBT-së, duke u mbështetur nga Megatek në përmirësimin e aftësive dhe njohurive të tyre në përputhje me kërkesat e tregut.



NEWSLETTER

Universiteti Bujqësor i Tiranës

Merr udhë Projekti UBT-BOKU 2030

Të lumtur të fillojmë rrugëtimin 4-vjeçar me një ndër universitetet më të mira në shkencat e jetës, Universiteti BOKU, Vjenë.

Në takimin e parë të bordit drejtues u prezantuan dhe dakordësuan hapat dhe aktivitetet kryesore për implementimin e këtij projekti, që synon përafrimin e UBT me standardet e BOKU.



MË TË LEXUAR:

WEB

[HTTPS://WWW.UBT.EDU.AL/BLOG/
KIZ-21/KIZ-LISTA-E-
KANDIDATEVE-PER-SENAT-
AKADEMIK-DHE-REKTOR-477](https://www.ubt.edu.al/blog/kiz-21/kiz-lista-e-kandidateve-per-senat-akademik-dhe-rektor-477)

UBREEN

Follow us:



UNIVERSITETIN
BUJQËSOR TË TIRANËS



UNIVERSITETI_BUJQËSOR
_TIRANES



Marrëveshje Bashkëpunimit mes UBT dhe D-Com, Shkollës së Mesme Bujqësore “Rakip Kryeziu,” PrimeTECH ALBANIA SHPK

Ambasadorja e Japonisë në Shqipëri, SH. S. Znj. Kato Kikuko viziton Universitetin Bujqësor të Tiranës

Të nderuar të presim në Universitetin Bujqësor të Tiranës Ambasadoren e Japonisë në Shqipëri, SH. S. Znj. Kato Kikuko në një vizitë në kuadër të Projektit “Read Japan Project” për dhurimin e disa librave në Bibliotekën Shkencore “Mentor Përmeti” në UBT.

Gjatë takimit u propozuan rrugë bashkëpunimi midis institucioneve akademike homologe duke krijuar ura të reja lidhëse mes dy shteteve të largëta me qëllim forcimin e zhvillimit të qëndrueshëm në fushën e bujqësisë dhe edukimit.



Një grup studentësh nga dy universitete partnere në Gjermani vizitojnë Universitetin Bujqësor të Tiranës

Universiteti Bujqësor i Tiranës u vizitua nga një grup studentësh të shkencave bujqësore të Universitetit Hohenheim dhe të Universitetit Nürtingen-Geislingen (NGU) në Gjermani. Në fjalën e tij përshëndetëse, Rectori i UBT, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku i njohu studentët me vendin që zë sektori i bujqësisë, mjedisit dhe ushqimit në ekonominë tonë dhe rolin që luan UBT në përgatitjen e profesionistëve, në kërkimin shkencor dhe në transferimin e njohurive dhe teknologjisë në këto fusha në vend.

Vizita studimore e studentëve gjermanë në UBT u organizua nga Prof. Dr. Myqerem Tafaj, Koordinator i Projektit Erasmus me këto Universitete, me qëllim thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit të UBT me universitetet partnere.



Prodhimi-Kultivimi i BMA-ve kostot, standardet, teknologjitë, përpunimi dhe tregjet e BMA-ve

Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit në mbështetje të Sektorit të Bimëve Medicinale dhe Aromatike për transferim të teknologjisë dhe njohurive në bujqësi në këtë sektor në Shqipëri.

Jemi në Malësinë e Madhe në kuadër të prezantimit të draftit të parë të Compendiumit të BMA-ve, një material njohurish që do t'i shërbejë si referencë kombëtare sektorit të BMA-ve.



Universiteti Bujqësor i Tiranës

Universiteti BOKU i Vjenës, Austri “MBËRRIN” në UBT

Të lumtur që pas shumë përpjekjesh dhe pune të palodhur nga ekipet e Universitetit BOKU dhe UBT, u finalizua në Vjenë Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë dedikuar posaçërisht projektit strategjik të Bashkëpunimit ndërmjet Universitetit BOKU, Vjenë dhe Universitetit Bujqësor të Tiranës. Nëpërmjet kësaj Marrëveshje, e cila është historike dhe më e rëndësishmja që një IAL në Shqipëri ka arritur, UBT është i gatshëm të ndërmarrë dhe implementojë reformën më të thellë të realizuar ndonjëherë në një universitet publik në Shqipëri, duke synuar ndryshimin total të arkitekturës aktuale të programeve mësimore dhe kërkimit shkencor.



MË TË LEXUAR:

WEB

[HTTPS://WWW.UBT.EDU.AL/SQ/BL-OG/UNIVERSITETI-13/UNIVERSITETI-BOKU-I-VJENES-AUSTRI-MBERRIN-NE-UBT-411](https://www.ubt.edu.al/sq/bl-og/universiteti-13/universiteti-boku-i-vjenes-austri-mberrin-ne-ubt-411)

UBREEN

Follow us:



UNIVERSITETIN
BUJQËSOR TË TIRANËS



UNIVERSITETI_BUJQËSOR
_TIRANES



Marrëveshje Bashkëpunimit mes UBT dhe Këshillit të Qarkut të Gjirokastrës, Bashkisë Memaliaj, Bashkisë Përmet

Vizitë e profesorëve dhe studentëve nga Universiteti HAS Green Academy, Holandë

Profesorët dhe studentët nga Universiteti HAS Green Academy, Holandë u pritën në një takim nga Rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku dhe stafi i tij, ku u njohën përmes një prezantimi të shkurtër me UBT, programet e studimit të nivelit Bachelor e Master, mundësitë dhe potencialet akademike e shkencore që ai disponon. U zhvillua një takim edhe me studentët e Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit dhe Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznes, i cili mori formën e një bashkëbisedimi të hapur për ndarje të eksperiencave dhe diskutimeve në grup mes studentëve nga të dyja palët.



Universiteti Bujqësor i Tiranës partner në Projektin “Startup10”, financuar nga Qeveria Italiane

Universiteti Bujqësor i Tiranës vazhdon të demonstrojë vlerat dhe kapacitetet e veta duke u bërë pjesë e Projektit “Startup10”, financuar nga Kooperacioni Italian dhe i zbatuar nga CIHEAM Bari, që synon promovimin e sigurisë ushqimore dhe punësimin e të rinjve në 10 vendet partnere: Shqipëri, Algjeri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Egjipt, Etiopi, Jordani, Kenia, Liban, Tunizi dhe Ugandë. Rektori i UBT Prof. Dr. Fatbardh Sallaku tha se UBT ka një sërë bashkëpunimesh në projekte të shumta shkencore me CIHEAM Bari, si një aktor kryesor në Shqipëri në transferimin e njohurive bujqësore, me qëllim nxitjen e krijimit të bizneseve të reja, të këshillojë politikanët dhe të rrisë rolin e tij për shoqërinë nëpërmjet implementimit të projekteve të tilla.



Universiteti Bujqësor i Tiranës pjesë e Panairit Mbarëkombëtar të Librit Akademik dhe Shkencor

Zëvendës Rektorja për Marrëdhëniet me Publikun dhe Institucionet, Prof. Asoc. Dr. Romina Koto teksa përshëndeti këtë nismë, theksoi se UBT është gjithnjë në shërbim të promovimit të botimeve akademike e shkencore duke suportuar lehtësimin e rrugës së librit akademik dhe shkencor drejt lexuesit.

Gjatë fjalës së saj, ajo prezantoi dhe disa nga botimet e fundit të profesorëve të UBT.



Në Universitetin Bujqësor të Tiranës hapet Qendra Gjeoinformative për Ballkanin Perëndimor

Kënaqësi që së bashku me Ministren e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Znj. Anila Denaj dhe Z. Karl Bergner, Ambasador i Republikës së Gjermanisë në Tiranë, morëm pjesë në hapjen për herë të parë në Universitetin Bujqësor të Tiranës të Qendrës Gjeoinformative për Ballkanin Perëndimor, në bashkëpunim me Institutin Leibniz për Zhvillimin Bujqësor në Ekonomitë në Tranzicion në Halle (IAMO), Gjermani dhe me financim nga Ministria Federale Gjermane e Ushqimit dhe Bujqësisë (BMEL).



MË TË LEXUAR:

WEB

[HTTPS://WWW.UBT.EDU.AL/BLOG/](https://www.ubt.edu.al/blog/aktivitete-9/UBT-PARTNER-NE-PROJEKTIN-AMORE-AL-PJESE-E-PROGRAMIT-APPEAR-PROGRAMI-I-PARTNERITETIT-AUSTRIAK-PER-ZHVILLIM-NE-ARSIMIN-E-LLARTE-DHE-KERKIMIN-SHKENCOR-380)
AKTIVITETE-9/UBT-PARTNER-NE-
PROJEKTIN-AMORE-AL-PJESE-E-
PROGRAMIT-APPEAR-PROGRAMI-
I-PARTNERITETIT-AUSTRIAK-PER-
ZHVILLIM-NE-ARSIMIN-E-LLARTE-
DHE-KERKIMIN-SHKENCOR-380

UBREEN

[HTTPS://UBGREEN.AL/DITA-
BOTERORE-E-UJIT-22-MARS/](https://ubgreen.al/dita-boterore-e-ujit-22-mars/)

Follow us:



UNIVERSITETIN
BUJQËSOR TË TIRANËS



UNIVERSITETI_BUJQËSOR
_TIRANES



UBT në panairin “Ditët e Informimit të Maturantëve” nëpër qytete

UBT partner në Projektin “AMORE-AL” pjesë e Programit APPEAR (Programi i Partneritetit Austriak për Zhvillim në Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor)

U zhvillua në Universitetin Bujqësor të Tiranës gjatë periudhës 6-7 Mars 2024 Kick off meeting, (takimi i parë hapës) në kuadër të projektit “AMORE-AL “Assessment of Pollutant Emissions to support River Basin Management in Albania according to the EU Water Framework Directive” financuar nga Austrian Development Cooperation APPEAR.



Universiteti Bujqësor i Tiranës hap të rëndësishëm drejt inovacionit dhe transferimit të teknologjisë e njohurive në bujqësi në sektorin e bimëve medicinale dhe aromatike në Shqipëri.

Për herë të parë në vendin tonë, UBT po ndërton një “Udhërrëfyes Kombëtar për Bimët Medicinale dhe Aromatike (BMA) në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përfaqësues të sektorit privat dhe aktorë të tjerë të zinxhirit të vlerës.

Udhërrëfyesi do t'i shërbejë sektorit privat me njohuri praktike mbi prodhimin, kostot, standardet, teknologjinë, përpunimin dhe tregjet e BMA-ve.



Rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku bashkë me stafin e tij pritën sot në një takim Ambasadorin e Bullgarisë në Shqipëri Z. Ivaylo Kirov dhe Përgjegjësin për Kulturën e Arsimit në Ambasadë Z. Asen Paçev, po ashtu edhe Përfaqësues nga Universiteti Trakia (Stara Zagora, Bullgari), Prof. Ilia Tsachev, Znj. Stoyanka Pastarmova dhe Z. Plamen Genov.

Gjatë takimit u diskutua rreth fushave të bashkëpunimit mes dy institucioneve akademike, duke ju referuar shkëmbimit të studentëve, stafit akademik, kërkimit shkencor dhe të shkëmbimit të teknologjive.



NEWSLETTER

Universiteti Bujqësor i Tiranës

Kërkimet shkencore në fushën e Antimikrobiko Rezistencës- fushë e rëndësishme e kërkimit shkencor në UBT

Si një ndër problemet më madhore e serioze, që përfaqëson ndoshta krizën më të madhe globale sot në shëndetin publik në botë, e ngjashme me ndryshimin e klimës, rezistenca antimikrobike (AMR) është bërë një ndër fushat kryesore kërkimore të stafit të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Në këtë kuadër, një ekip studiuesish nga Boston University, USA, konkretisht Dr. Indorica Sutradhar, Dr. Darash Desai dhe Neila Gross, zhvilluan një leksion të hapur me temë: Antimicrobial Resistance-Research and Inovation.



MË TË LEXUAR:

WEB

[HTTPS://WWW.UBT.EDU.AL/BLOG/UNIVERSITETI-13/MUNDESI-PRAKTIKE-PER-GJENDJEN-NE-RAJONIN-ADRIATIK-JONIAN-360](https://www.ubt.edu.al/blog/universiteti-13/mundesipraktike-per-gjendjen-ne-rajonin-adriatik-jonian-360)

UBREEN

[HTTPS://UBGREEN.AL/CFARE-SHKAKTON-MUNGESA-E-ZINKUT-NE-ORGANIZEM/](https://ubgreen.al/cfare-shkakton-mungesa-e-zinkut-ne-organizem/)

Follow us:



UNIVERSITETIN
BUJQËSOR TË TIRANËS



UNIVERSITETI_BUJQËSOR
_TIRANES



UBT në panairin “Ditët e Informimit të Maturantëve”

UBT partner në projektin me titull “Platform for helping small and medium farmers to incorporate digital Technology for Improved Opportunities PHITO”

Për herë të parë UBT është pjesëmarrës në një projekt serioz të financuar nga HORIZON-IA për periudhën 2023-2028.

Ky projekt prezanton një teknologji dixhitale novatore posaçërisht për fermerët e vegjël dhe të mesëm (SMF) që aktualisht nuk janë në gjendje të përfitojnë nga inovacioni dixhital i adoptuar gjithnjë e më shumë nga prodhuesit më të mëdhenj.



Fakulteti i Shkencave Pyjore feston 60-vjetorin e “Ditës së Inxhinierit të Pyjeve”

Në kuadër të kësaj dite të shenjuar, Rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave Pyjore, Prof. Dr. Leonidha Peri pritën në një takim Znj. Anisa Ruseti, Drejtoresha e Përgjithshme e Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit - Bashkia Tiranë dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, Z. Artur Kala.

Pjesëmarrësit në këtë takim diskutuan mbi gjendjen aktuale dhe sfidat e sotme e të së ardhmes për profesionin e inxhinierit të pyjeve, duke prekur dhe mundësitë e tregut të punës nga sektori shtetëror dhe privat për specialistët e rinj.



Universiteti Bujqësor i Tiranës firmos Marrëveshje Bashkëpunimi me kompanitë BroTech Brands dhe F&M Reklama me qëllim ofrimin e praktikave mësimore dhe punësimit të studentëve.

Për të firmosur marrëveshjet Rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku priti në një takim Administratorin e kompanisë F&M Reklama, Z. Faolt Pahija.

Palët angazhohen në realizmin e projekteve apo aktiviteteve të përbashkëta për praktika profesionale të studentëve, kërkimin shkencor, transferimin e njohurive, të teknologjisë, trajnimeve apo shërbimeve të tjera.



NEWSLETTER



Universiteti Bujqësor i Tiranës

Përfundon rindërtimi i godinës së Fakultetit të Bioteknologjisë së Ushqimit dhe Klinikës Veterinare

Universiteti Bujqësor përfundon rindërtimi i godinës së Fakultetit të Bioteknologjisë së Ushqimit dhe Klinikës Veterinare, investime që kanë krijuar kushtet më të mira për 2,400 studentë dhe mbi 140 pedagogë të UBT.

Fokusi kryesor është ndërkombëtarizimi, përmes programeve të përbashkëta me universitete prestigjioze në Europë, siç është Universiteti Boku i Vjenës, me të cilin po formalizohet bashkëpunimi me UBT, për të përmirësuar standardet e arsimit në Shqipëri.



MË TË LEXUAR:

WEB

[HTTPS://WWW.UBT.EDU.AL/BLOG/ERASMUS-3/THIRRJE-CORDOVA-2024-348](https://www.ubt.edu.al/blog/erasmus-3/thirrje-cordova-2024-348)


UBREEN

SI MUND T'I PËRGJIGJET
BUJQËSIA QELIZORE
KËRKESAVE GLOBALE NË
RRITJE PËR USHQIM?

Follow us:



UNIVERSITETIN
BUJQËSOR TË TIRANËS



UNIVERSITETI_BUJQËSOR
_TIRANES



101 VJETORI I SHËRBIMIT PYJOR

Ambasadorja e Francës në Shqipëri viziton për herë të parë Universitetin Bujqësor të Tiranës

Rectori i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku priti në një takim Ambasadoren e Francës në Shqipëri, SH. S. Znj. Catherine Suard dhe stafin e saj, Z. Pierre Raynaud (Këshilltar për Bashkëpunimin dhe Kulturën) dhe Z. Alexandre Martinez (Këshilltar Rajonal për Çështjet e Bujqësisë dhe Ushqimit).



UBT nënshkruan Marrëveshje Bashkëpunimi me Rrjetin Shqiptar për Zhvillimin Rural

Marrëveshja e firmosur nga Rectori i UBT, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku dhe Znj. Evelina Azizaj, Koordinatore Kombëtare e ANRD ka për qëllim bashkëpunimin e qëndrueshëm mes dy palëve në fusha me interes të përbashkët të tilla si: edukimi dhe trajnimi profesional, kërkimi shkencor, dialogu për politikën e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimi i qëndrueshëm bujqësor e rural.

Fondacioni Federal Gjerman për Mjedisin (DBU) mbajti një sesion informues para studentëve dhe pedagogëve të UBT

Z. Alexander Bittner, Përgjegjës në DBU për Programin CEE për Ballkanin Perëndimor dhe Znj. Claudia Domel, Përgjegjëse për Projektet Ndërkombëtare për Europën Qendrore dhe Lindore ofruan një informacion të detajuar mbi mundësitë që ofron DBU për studentët dhe stafin akademik të UBT.

Rectori i Universitetit Bujqësor të Tiranës, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku teksa mirëpriti delegacionin përfaqësues nga DBU, i njohu ata edhe me një pasqyrë të përgjithshme të UBT dhe të prespektivave të tij për të ardhmen në funksion të zhvillimit të edukimit, kërkimit shkencor dhe transferimit të njohurive.

